



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.305, datë 23.09.2021

**PËR CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR FILLIMIN E PROCEDURËS
SË NGRITJES NË DETYRËN E DREJTUESIT PËR KANDIDATIN QË KA
KALUAR PROCESIN E VERIFIKIMIT**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159 pika 2 germa “i”, 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “ç”, 190 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 19 pika 1 e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”,

V E N D O S I:

1. Caktimin me short të relatorit për procedurën e ngritjes në detyrën e drejtuesit për kandidatin që ka kandiduar për vendin vakant të drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si më poshtë:

- Pozicion vakant i Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, relator Znj. Eloida Goxhi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR



GENT IBRAHIMI